



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **18**

Prishtinë, më 16.07.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zylfi Merxha, dhe Myrvete Pantina.

Munguan : Ibrahim Selmanaj, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Zef Morina, dhe Ali Lajçi,

Pjesëmarrësit tjerë : Nexhat Shatri nga Presidenca

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi, konstatoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar të shtyhet për mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht

Kryesuesi i komisionit lidhur me këtë pikë tha se ne si komision kemi bërë amendamentet e pjesës dërmuese të neneve të Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht.

Komisioni konstatoi se kanë mbetur dy nene kontestuese, neni 28 dhe nenin 29. Konkretisht lidhur me nenin 28, të sqarohet se në cilën përbërje është formuar dhe sa anëtarë duhet ti ketë ky

Këshillë. Në të njëjtin nene të sqarohen fjalët ‘Autoriteti kompetent’ në cilën njësi organizative funksionon ky autoritet.

Gjithashtu të ofrohen sqarime lidhur me nenin 29, sa i përket ‘Këshillit Etikë’ sa është i nevojshme që ky term të ekzistojë (mbetet) në Projektligj.

për të cilat është marrë qëndrim që përfaqësuesit e Ministrisë të japin qëndrimet e tyre në mbledhjen e radhës të komisionit.

Pasi përfaqësuesit e Ministrisë nuk prezantuan në mbledhje të komisionit, komisioni mori qëndrim që për mbledhjen e radhës të caktuar me datën 21.07.2008 të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë që të japin qëndrimet e tyre dhe ekspertët e kësaj fushe: drejtori i Institutit të Bujqësisë në Pejë - Fadil Musa, Prof. në Fakultetin e Bujqësisë-Gjenetike – Shukri Fetahu Adem Arifaj dhe Selim Kolgeci.

Të ndryshme

Kryesuesi i njoftojë anëtarët tjerë të komisionit se në takimin e Kryesisë së Kuvendit e cila u mbajti me datën 16.07.2008, me shefat e grupeve Parlamentare, ka kërkuar që çështja e Prevallës të debatohet në njërin nga Seancat e Kuvendit të Kosovës si çështje me interes.

Në pikën e tretë diskutuan: Lulzim Zeneli, Elheme Hetemi, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Kosara Nikolić, dhe Zylfi Merxha, lidhur me vizitën që është bërë në Komunën e Deçanit. Pas konstatimit se gjendja është shumë alarmante lidhur me prerjen e Pyjeve, u pajtuan që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen dhe të miratohen Rekomandimet lidhur me çështjen e Pyjeve në vend.

Vizita në Deçan u caktua për ditën e enjte më 24.07.2008 , nisja nga Kuvendi në orën 8,00. Komisioni do të takohet me zyrtarët komunal të Deçanit në orën 10,00 , prej nga do të vazhdohet të bëhet vizita në vendet më të prekura të pyjeve të Deçanit.

Anëtarët e komisionit Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Elheme Hetem, ishin të mendimit që komisioni të bëjë trusni në Ministri, veçmas për anulimin e tenderit për prerjen e drunjtëve për një kohë të caktuar.

Mbledhja e radhës u caktua me datën 21.07.2008 në ora 10:00 në sallën N-225

Mbledhja përfundoi në orën 13:50

Përgatitu

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Lulzim Zeneli